

Dt 23/10/2017

## STATUT

I Shoqerise private BERBERI COMPANY SH.P.K Bilisht ne adresen Lgj nr 2 , rruga Superstrada e Devollit ,objekti nr 153 Kati I

Mario Berberi I biri i Maksit i datelindjes 01/07/1992

Ortaku i vetem i shoqerise BERBERI COMPANY SH.P.K banues ne qytetin e Bilishtit, duke u bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe te plote, me mirekuptim te ndersjellte ne baze te ligjit nr.9901 date 14.05.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" hartoi e nenshkroi statusin e saj me kete permbajtje

### Kreu I

#### Dispozita te Pergjithshme

##### Neni I

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar BERBERI COMPANY SH.P.K me seli ne Bilisht Lgj nr 2 , rruga Superstrada e Devollit ,objekti nr 153 Kati I ,ne perputhje me vendimin Nr \_\_\_\_\_ te qkb-se per krijimin e shoqerise dhe me legjislacionin shqiptar,regullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne Shqiperi,te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik,organizimin dhe objektin e veprimtarise se Shqiperise dhe ceshtjet e tjera me rendesi per punen e shoqerise.

##### Neni 2

Shoqeria sipas nenit 1 dhe nenit 2 te ketij statuti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "SHOQERIA BERBERI COMPANY SH.P.K"

##### Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Lgj nr 2 , rruga Superstrada e Devollit ,objekti nr 153 Kati I Bilisht.

##### Neni 4

Shoqeria do te kete vulen me emertimin e saj

##### Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise private "BERBERI COMPANY SH.P.K" eshte ne fushen e Tregetise me shumice dhe pakice. Import-Eksport te mallrave dhe produkteve ushqimore



industriale ,produkteve bujqesore e blegtorale, bimeve medicinale ,fruta - perime ,prodhime veshmbathje produkte kozmetike dhe estetike kimike dhe detergjenteve. Transport te te gjitha mallrave dhe produkteve brenda dhe jashte vendit per vete dhe per te trete. Grumbullimit,perpunimit tregetimit me shumice dhe pakice te te gjithe` produkteve te siperpermedura etj.

Neni 6

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne territorin e Republikes se Shqiperise.Per kryerjen e kesaj veprimtarie ajo mund te cele dege dhe zyrat e saj te perfaqesimit ne vend dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise,ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe te vendit ku celen ato.

Neni 7

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin,duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit,sigurise dhe rentabilitetit

Neni 8

Pjesmarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket qe te kene pavarsi ligjore per veprime te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Neni 9

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

-Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me statutin,vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.

-Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise,te cdo forme e sasi qofte ne perputhje me kontraten e statusin.

-Te marrin pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.

-Te kerkojne tu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen peodhuese e tregetare te shoqerise ,si dhe me gjithe dokumentat e perpunuara nga shoqeria si:balancet,llogarite ekonomike etj.

-Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

Neni 10

Ortaket kane keto detyra kryesore:



-Te depozitohen kuotën e tyre në përputhje me kontratën(aktin)e themelimit të shoqërisë dhe me këtë statut.

-Te marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tyre,vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

-Ti japin shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.

-Te kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave dhe realizimin e veprimtarisë së saj.

#### Neni 11

Secili ortak pjesën e kapitalit të vetë mund ta transferojë në person të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri por vetëm me miratimin e ortakëve të tjerë.Projekt vendimi për transferimin i njoftohet shoqërisë dhe secilit ortak.Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj Brenda tre muajve nga dita e njoftimit,miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

#### Kreu 11

#### Kushtet ekonomike

#### Neni 12

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të parimeve të shoqërisë e pasqyrohet në bilancet e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 13

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë caktohet një kapital themelor prej 100.000 lek e ndarë në një kuotë.Ortakët marrin pjesë në krijimin e kapitalit themelor me kuota të barabarta.Afatet e derdhjes së kapitalit janë të ndara në kuota për secilin ortak,depozitohen në banka për llogari të shoqërisë nga administratori.Administratori u dorezon ortakëve një dokument me të cilin vërtetohet derdhja e kuotave në të holla prej tyre.

#### Neni 14

Shoqëria në emër të saj është pronare,përdoruese e pasurive të saj për gjithmone në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen.Shoqëria mund të blejë pasuri ose të ofrojë pasurinë e saj për garanci për të marrë kredi bankare.

#### Neni 15

Shoqëria krijon fondin reserve ose fonde të tjera të vecante financimi për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e veta financiare.Detyrimet eventuale që



mund të lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondi reserve ose nga shumat elementare qe kur deshirojne mund ti derdhin oraket.

### Kreu III Administrimi

#### Neni 16

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve,e cila me unanimitet vendos per te gjitha ceshtjet qe mer ne shqyrtim,si per bilancin vjetor,ndryshimet ne statut,per shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor,per emertimin e administratorit,per pakesimin e drejtimive kryesore per shkrirjen ose mbylljen fare te saj. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

#### Neni 17

Asambleja e ortakeve mblidhet rregullisht nje here ne tre muaj,,ditet e fundit te muajit te trete.Me kerkesen e cdo ortaku asambleja mund te mblidhet edhe jashte radhe,Secili ka te drejte dhe vota te njejta ne mbledhjen e asamblese me ortaket e tjere

#### Neni 18

Asambleja e ortakeve ne zbatim te legjislacionit ne fuqi dhe ketij statut emerone si administrator per nje afat 5 (pese)vjecar

#### Neni 19

Shoqeria administrohet nga administrator I cili perfaqeson shoqerine kundrejt te treteve brenda caqeve te veprimtarise se saj,ne mbeshtetje te legjislacionit Shqiptar,si dhe kryerjen e te gjithave veprimeve te administrimit ne interes se shoqerise.

-Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike pas perpunimit te tyre.

-Te beje propozimet e nevojshme ne Asamblene e Ortakeve per ndryshimin kur lind nevoja te kapitalit te shoqerise

-Te miratoje akte normative,te percaktoje raporte ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.

-Te krijoje organet e tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.



- Te propozoje ne asamblene e orakeve per krijimin e njesive srtukurore si filial,dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit ose jashte shtetit
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe ta paraqese ate ne Asamblene e Ortakeve per miratim.
- Te perzgjedhe ekspert kontabel dhe antaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqese propozimet per miratimin ne asambel.
- Te siguroje zbatimin e përpikte te vendimeve te Asamblese se Ortakeve
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

Neni 20

Veprimtaria operative e shoqerise administrohet nga administrator i saj i cili perben organin ekzekutiv .Ai ka keto detyra te tjera:

- Organizon dhe ndjek punen per zbatimin e detyrave qe rrjedhin nga planet ekonomike e financiare te shoqerise
- Ndjek zbatimin konkret te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.
- Administron veprimtarine e filialeve,perfaqesive ose degeve me procure ose sipas vendimit te asamblese
- Perfaqeson shoqerine para te treteve ne gjykate ,ne arbitrazh dhe ne organet e tjera shteterore.
- Nenshkruan kontrata ne emer dhe per llogari te shoqerise.
- Raporton para asamblese dhe pergjigjet para saj per veprimtarine e shoqerise ne kuader te kompetencave te tij.
- Per cdo veprim ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi dhe kete statut pergjegjesia e Administratorit eshte individuale si ajo financiare dhe ligjore.

#### Kreu IV

#### Kohezgjatja e Veprimtarise

Neni 21

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet ne nje periudhe mbi 10 vjet,te nje pas njeshme,me te drejte zgjatje te ketij afati.

Mardheniet e Punes



Neni 22

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise legjislacionin shqiptar dhe kete statut.

Neni 23

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates se punes

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshteje:

Kushtet menyra e marrdhenies se punes,fillimi i punes dhe caktimi i vendit te punes,koha e punes,puna e nates,puna jashte kohes normale,puna diten e pushimit javor dhe festive zyrtare,mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes,pushimet dhe mungesat,te drejtat dhe detyrimet pergjegjesite e punonjesve pushimi l mardhenies se punes,paga dhe shperblimi i punes etj.

Neni 24

Asambleja e Ortakeve ne unanimitet zgjodhi si Administrator te saj Z Mario Berberi

Kreu V

Te vecanta,Mbyllja dhe Likujdimi

Neni 25

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e punes dhe per zbatimin e detyrave ne menyre te ligjshme dhe profesionale.

Neni 26

Veprimtaria e shoqerise perfundon e percaktuar ne kontraten e themelimit ose me pare sipas propozimit te bere prej ortakeve kur veprimtaria e saj rezulton jo rentable.Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimit.

Neni 27

Kur shoqeria likujdohet Asambleja e ortakeve emeron komisionin e likujdimit i cili paraqet per miratim bilancin e likujdimit te shoqerise.Mjetet financiare dhe cdo pasuri tjeter kur shoqeria likujdohet,ndahet ndermjet ortakeve,pasi te jene bere pagesat kreditoreve.

Asambleja e Ortakeve

Ortaku i Vetem

Mario Berberi

